



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

### I

## AVOKATIT TË POPULLIT

**lidhur me vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë**

**Për: Znj. Dhurata Hoxha, Ministre**  
**Ministria e Drejtësisë**

**Z. Milazim Gjocaj, Drejtor i Përgjithshëm për Shëndetësi në Burgje,**  
**Ministria e Shëndetësisë**

**Z. Imet Rrahmani, Ministër**  
**Ministria e Shëndetësisë**

**Z. Sokol Zogaj, u.d. Drejtor i Përgjithshëm**  
**Shërbimi Korrektues i Kosovës**

**Z. Rasim Selmanaj, drejtor**  
**Burgu i Sigurisë së Lartë**

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr.05/L-019, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Burgun e Sigurisë së Lartë.

Prishtinë, më 19.06. 2017

## Datat e vizitës dhe përbërja e grupit monitorues

1. Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 17, 21 dhe 31 mars 2017 ka vizituar Burgun e Sigurisë së Lartë (në tekstin e mëtejshëm “BSL”). Grupi monitorues përbëhej nga dy juristë, një mjek dhe një psikologe.

## Përshkrimi i përgjithshëm i institucionit

2. BSL gjendet në Fshatin Gërdoc, Komuna e Podujevës, në magjistralen Prishtinë-Podujevë. BSL filloi punën në maj të vitit 2014 kur edhe filloi pranimi i të dënuarve me rrezikshmëri të lartë. Ky burg ofron tri regjime: regjimin themelor, standard dhe atë të avancuar. Kapaciteti i BSL-së është 390 persona. BSL përbëhet nga sektori i administratës, stacionari shëndetësor, pavijoni 1,2 dhe 3, si dhe objektet përcjellëse.
3. **Në kohën kur MKPT e vizitoi BSL, aty ishin të vendosur 123 persona të dënuar (pavijoni 1 dhe 2), 23 të paraburgosur (të cilët mbahen në pavijonin 3) dhe 3 dëshmitarë të mbrojtur.** Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) e ka vizituar BSL gjatë vizitës *Ad Hoc* në Kosovë në vitin 2015.<sup>1</sup>

## Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

4. Gjatë vizitës së MKPT në BSL, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e burgut. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër. Po ashtu, MKPT u lejua të përdor edhe pajisjet teknike për të kryer detyrën në pajtim me nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

## Keqtrajtimi

5. **MKPT gjatë vizitave në BSL ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të burgosurve dhe nuk ka pranuar ankesa për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues.**

## Kushtet materiale

6. Kushtet materiale në BSL në përgjithësi janë të mira dhe ofrojnë komoditet për të burgosurit, të cilët janë të vendosur në qeli vetëm. Të gjitha qelitë ofrojnë dritë natyrale të mjaftueshme, hapësirë të mjaftueshme, TV, tualete të pastra dhe të burgosurit mund të bëjnë dushe sa herë që duan. Qelitë janë të pajisura me krevat, çarçafë, tavolinë, karrige dhe sistem të thirrjes.
7. Sa i përket qasjes së personave me aftësi të kufizuara (edhe pse nuk kishte të tillë), të gjithë ashensorët ishin funksional, gjë që qasja e tyre nuk dukej të ishte problem. BSL u siguron të burgosurve pako higjienike mujore dhe pako për pastrim të krahut ku ata janë të vendosur. **MKPT nuk ka pranuar ankesa sa i përket kushteve të akomodimit në**

---

<sup>1</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë, nga 15 deri më 22 prill 2015, raporti u publiku në shtator të vitit 2016, shih në:  
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806a1efc>

**BSL. Po ashtu, MKPT nuk ka pranuar ankesa sa i përket cilësisë së ushqimit i cili u ofrohet të dënuarve dhe të paraburgosurve në BSL.**

8. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se dyshemetë në pavijonin 1, 2 dhe në stacionarin e BSL-së janë dëmtuar dukshëm, gjithashtu në pavijonin 1 banjat nuk kishin izolim të mirë, kishin filluar me pikë ujë, muret kishin lagështi. Sipas drejtorisë këto dëmtime janë pasojë e punimeve jo kualitative të kryera nga kompania e angazhuar e të cilat janë pranuar teknikisht.
9. Lidhur me këtë drejtori i burgut e ka njoftuar MKPT se *“janë ndërmarr veprime me qëllim të sanimit të gjendjes dhe deri me tani janë rregulluar tri banja të pavijonit 1 dhe kanë mbetur që të rregullohen edhe tri të tjera gjatë muajve në vazhdim”*. **MKPT do të vazhdojë të kërkojë informata të përditësuara nga SHKK lidhur me evitimin në tërësi të këtyre mangësive.**
10. Gjatë vizitës së KPT-së në Burgun e Sigurisë së Lartë<sup>2</sup>, u potencua si problem muret dhe terrenet për aktivitete sportive dhe shëtitje të cilat janë të ndërtuara nga betoni me ngjyrë të bardhë dhe shkaktojnë një reflektim verbues të diellit sidomos gjatë stinës së verës dhe KPT u rekomandoi autoriteteve relevante në Republikën e Kosovës që këto mangësi të evitohen. **Në përgjigjen e dërguar KPT-së nga autoritetet relevante të Kosovës thuhej se po shqyrtoheshin mundësitë buxhetore të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) për të evituar këto mangësi gjatë vitit 2016.**
11. Gjatë vizitës së fundit të MKPT-së (mars 2017), u pa që ende mbeten problem muret dhe terrenet për aktivitete sportive dhe shëtitje të cilat shkaktojnë reflektim verbues të diellit, gjithashtu edhe personeli mjekësor në BSL u pajtuan se ankesat e të burgosurve janë të bazuara dhe se kjo gjendje është problematike dhe duhet të gjendet një zgjidhje nga autoritetet kompetente.
12. **Lidhur me këtë problem, drejtori i burgut e njoftoi me shkrim MKPT se “është duke u punuar në këtë drejtim që këto mure të ngjyrosen me qëllim që të mos shkaktojnë reflektim. Në ndërkohë drejtorja ka lejuar që të dënuarit të mbajnë syze dielli dhe kapela me qëllim që tu lehtësohet qëndrimi në shëtitore derisa të bëhet zgjidhje.”** MKPT do të vazhdojë të përsëris rekomandimin dhe përcjellë aktivitetet dhe planin e SHKK-së lidhur me evitimin e këtij problemi.
13. MKPT u njoftua se ka dy vite që të burgosurve nuk u shpërndahet shtypi ditorë. **MKPT rithekson se ofrimi i shtypit ditor është e drejtë e cila të burgosurve u garantohet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.**<sup>3</sup> Në përgjigjen e SHKK-së thuhet se *“Shtypi ditor është po ashtu një mangësi e cila duhet të evitohet. Ne si institucion ofrojmë 9 programe televizive me qëllim të informimit sa më të mirë të dënuarve”*.
14. MKPT ka vërejtur se të dënuarit dhe të paraburgosurit mbahen të ndarë në pavijone të ndryshme, në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë, nga 15 deri më 22 prill 2015, raporti u publiku në shtator të vitit 2016, shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806a1e1c>, paragrafi 36

<sup>3</sup> Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 87: *“Personi i dënuar ka të drejtë të ketë qasje në shtypin ditor dhe atë periodik në gjuhën e tij amtar e dhe në burime të tjera të informimit publik”*.

<sup>4</sup> Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 33.7: *“Personat e dënuar nuk vendosën në të njëjtën pjesë të institucionit me personat e paraburgosur”*

## Regjimi

15. BSL ofron 3 regjime për të burgosurit: regjimi themelorë, standard dhe i avancuar. Në BSL, rreth 80 të dënuar janë të angazhuar në punë. Angazhimi në punë është më i madh gjatë stinës së verës. Zakonisht të dënuarit angazhohen në punë në kuzhinë dhe në pastrim. Të dënuarit mund të lëviznin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur brenda kohës së caktuar, p.sh të burgosurve në regjim themelorë dhe standard dera ju lihet hapur deri në ora 16:00 pasdite; të burgosurve në regjim të avancuar deri në ora 18:00; ndërsa dëshmitarëve të mbrojtur deri në ora 19:00. Të burgosurit gjithashtu dalin në shëtitje 2 orë në ditë.<sup>5</sup>
16. Për momentin, nuk ofrohen trajnime apo kurse, edhe pse BSL posedon objektin për trajnime profesionale. Sipas drejtorisë, janë duke u angazhuar për organizimin e një kursi për kompjuterë i cili mund të mbahet pas certifikimit të një zyrtari të BSL i cili më pastaj do të konsiderohet kompetent për të mbajtur këtë kurs me të burgosurit.
17. Biblioteka në BSL, sipas autoriteteve, posedon rreth 150 tituj me libra. Kohëve të fundit, sa i përket literaturës fetare, SHKK së bashku me Bashkësinë Islame të Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë veprime përmes së cilave janë larguar nga bibliotekat e qendrave korrektuese dhe të paraburgimit titujt e librave fetare të cilët janë vlerësuar se përmbajnë ideologji ekstremiste.
18. Sa i përket ushtrimeve fizike, MKPT ka vizituar objektin ku të burgosurit mund të bëjnë fitnes 3 herë në javë. Objekti ofron kushte të mira dhe pajisje të mjaftueshme për ushtrime fizike.<sup>6</sup> Por aktivitetet fizike dhe sportive në terrenin sportiv jashtë hapësirave të pavijoneve është vështirë të bëhen për shkak të reflektimit të ngjyrës së bardhë siç u theksua më lartë në raport.<sup>7</sup>
19. MKPT u njoftua se një i dënuar është duke punuar në një projekt të energjisë alternative për të cilin ka aplikuar për patentim pranë ministrisë kompetente. **MKPT rithekson rëndësinë e ofrimit të programeve të kënaqshme me aktivitete (puna, edukimi, sporti etj.) për mirëqenien psiko-fizike të të burgosurve.**<sup>8</sup>
20. Sa i përket regjimit për të paraburgosurit, mbetet i varfër pasi që aktivitetet e tyre në përgjithësi kushtëzohen me lejen nga gjykata kompetente<sup>9</sup>. Po ashtu ata kanë të drejtë në 2 orë shëtitje gjatë ditës. **MKPT inkurajon autoritet kompetente të rrisin aktivitetet jashtë qelisë në BSL për të paraburgosurit. KPT në raportet për vizitat në shtetet e ndryshme konsideron se sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes në paraburgim, po aq duhet të jetë i zhvilluar edhe regjimi i cili u ofrohet.**<sup>10</sup>

<sup>5</sup> Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë në së paku dy orë shëtitje.

<sup>6</sup> Neni 37 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “Personi i dënuar ka të drejtë që të merret me ushtrime fizike aq sa është e nevojshme për ruajtjen e shëndetit të tij dhe të kalojë së paku dy (2) orë në ditë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë. Nëse moti është i mirë, personi i dënuar mund të merret me ushtrime fizike në ambient të hapur”.

<sup>7</sup> Paragrafi 10 i këtij raporti.

<sup>8</sup> Shih standardet e rishikuara të KPT, 2015, *paragrafi 47*.

<sup>9</sup> Neni 200 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente”.

<sup>10</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë, nga 15 deri më 22 prill 2015, raporti u publiku në shtator të vitit 2016, shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806a1efc>. Raporti i Komitetit Evropian për Vizitën në Gjeorgji në vitin 2014, i publikuar në vitin 2015 në:

21. Sa i përket aktiviteteve për të paraburgosurit, në përgjigjen e drejtorit të burgut, theksohet se *“për të paraburgosur ne kemi vendosur në sallat e rekreacionit fusha të pingpongut dhe jemi në procedurë që të sigurojmë pajisjet për fitnes për të paraburgosur”*.

### **Kujdesi shëndetësorë**

22. Përgjegjësia për kujdesin shëndetësorë në Shërbimin Korrektues u transferua nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë në korrik të vitit 2013. Në BSL funksionon stacionari i burgut i cili ofron shërbime mjekësore për të burgosurit. **MKPT vizitoi të gjitha hapësirat e stacionarit dhe ka konstatuar se shërbimet që ofrohen në BSL janë të nivelit ambulatorë, pra nuk i plotëson kushtet e një stacionari.**
23. Në BSL janë të angazhuar 3 mjek të rregullt që e mbulojnë shërbimin 7 dite 12 orë në ditë, një kardiolog i cili angazhohet kohë pas kohe, 1 kryeinfermier dhe 5 infermierë të cilët punojnë në ndërrime nga 12 orë. Po ashtu, dy herë në javë ofrohen shërbime nga psikiatri dhe stomatologu. BSL ka të angazhuar një psikolog me orar të plotë, i cili njëkohësisht është edhe ushtrues detyre i koordinatorit për shërbime shëndetësore.
24. Stacionari i burgut mban regjistrat si në vijim: regjistri i vetëlëndimeve, lëndimeve trupore, tentim vetëvrasjeve, abuzimit me substanca narkotike, abuzimit seksual, i grevës së urisë si dhe regjistri i vetmisë. Gjithashtu secili mjek posedon protokollin e vizitave të pacientëve.
25. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollat mjekësore sidomos në rastet e të burgosurve apo të paraburgosurve të sapo-pranuar, jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.
26. BSL e njoftoi ekipin e MKPT-së se të sapo pranuarit kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në qendër, gjatë së cilës i burgosuri pyetet për ndonjë sëmundje e cila, nëse deklarohet, regjistrohet në dosjen e tij mjekësore.
27. Gjatë vizitës janë kontrolluar disa dosje mjekësore bazuar në ankesat e pranuar nga të burgosurit. Në rastin e të burgosurit F.G, MKPT ka konstatuar se të burgosurit nuk mund t'i ofrohen shërbime e nevojshme mjekësore në stacionarin e BSL-së. Po ashtu, personeli mjekësor i pohoi MKPT-së se nuk kanë mundësi që të burgosurit në fjalë t'i ofrojnë shërbimet e duhura mjekësore bazuar në natyrën e sëmundjeve të tij.
28. Lidhur me rastin F.G. MKPT u njoftua me shkrim nga drejtori, se pas vlerësimit dhe rekomandimit mjekësor, rasti në fjalë është transferuar në stacionarin e QK.Dubravë.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

29. Gjatë vizitës në stacionarin e burgut, MKPT u informua se shërbimet mjekësore, të burgosurve u jepen pa prezencë të zyrtarëve korrektues, por zyrtarët korrektues qëndrojnë në korridor dhe vëzhgojnë situatën nëpërmjet dritares së vogël të derës së dhomës së mjekut. **Sipas standardeve të KPT të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve**

**duhet të bëhen larg dëgjimit dhe shikimit të zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur mjeku kërkon ndryshe.<sup>11</sup>**

### **Trajnimet për shërbimin mjekësor**

30. Sipas stafit shëndetësorë, infermierët janë duke i ndjekur trajnimet në dy fusha: e para është për shëndetin mendorë dhe fusha tjetër është për emergjencë. Gjithashtu, MKPT u informua se përmes projektit të Këshillit të Evropës ka filluar trajnimi i disa personave nga personelit shëndetësorë i burgjeve ku në fazën e parë do të krijohen grupe punuese për të identifikuar se cilat janë nevojat për trajnime të mëtutjeshme për stafin mjekësorë në përgjithësi. Psikologu i BSL-së është i angazhuar në këto trajnime të Këshillit të Evropës. Sipas njoftimit të psikologut, të gjithë psikologët e angazhuar me punë në burgje janë duke punuar në përpilimin e baterisë së testeve psikologjike dhe protokolleve të punës në mënyrë që ato të jenë unike për të gjitha burgjet.
31. **Pas përfundimit të vizitës dhe raportit të MKPT-së, drejtorja e shëndetësisë së burgjeve njoftoi me shkrim MKPT-në, se ka përfunduar trajnimi i organizuar nga profesorët e emergjencës, i certifikuar nga Bordi për zhvillim të vazhdueshëm profesional, 4 ditë rresht, ku janë trajnuar i tërë stafi i burgjeve dhe kanë marrë certifikata. Ky trajnim ka pasur për qëllim dhënien e ndihmës së parë dhe reanimimin me in- tubim dhe përdorimin e mjeteve për ringjallje që posedojnë ambulancat e burgjeve. MKPT përshëndet iniciativat e stafit mjekësor dhe kjo në vazhdimësi do ta motivojë dhe avancojë edhe më shumë stafin mjekësorë në këto institucione.**

### **Personeli i BSL**

32. Bazuar në informatën e marrë nga drejtorja, personeli i BSL përbëhet nga 140 zyrtarë, përfshirë këtu personelin teknik dhe administrativ. SHKK ka shpallur konkurs publik për rekrutim të 70 zyrtarëve korrektues të cilët do të shërbejnë në BSL dhe në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan. **MKPT do të kërkojë informata të përditësuara nga SHKK lidhur me këtë proces i cili pritet të ndikojë pozitivisht në menaxhimin e këtyre dy qendrave korrektuese.**
33. Sipas drejtorisë, BSL për momentin përballet me mungesë të një numri më të madh të personelit menaxhues, mungesë të pagesës së rrezikshmërisë sipas nivelit të rrezikut (nuk bëhet dallimi i nivelit të rrezikshmërisë në burgje), zyrtarët korrektues të cilët kryejnë detyrat e ushtruesve të detyrave nuk paguhen sipas detyrave të cilat i kryejnë, por vetëm si zyrtarë korrektues dhe po ashtu nuk gëzojnë stazh të beneficuar.
34. MKPT është e mendimit se personelit të burgut duhet t'i ofrohen kushte të mira të punës në mënyrë që ata të ndihen të vlerësuar dhe respektuar për punën që bëjnë dhe në këtë mënyrë rriten gjasat se ata të njëjtin vlerësim dhe respekt do ta zbatojnë në trajtimin e të burgosurve. Kushtet e kënaqshme të punës po ashtu janë të rëndësishme për të tërhequr dhe mbajtur personelin adekuat.

### **Trajnimet për personelin korrektues**

35. Gjatë këtij viti, pas një vlerësimi të çështjes së radikalizmit në burgjet e Kosovës, ICITAP (Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Hetimet Penale, Departamenti i Drejtësisë i SHBA) në muajin mars 2017 ka organizuar një tryezë pune me pjesëtarët e SHKK dhe organeve tjera shtetërore, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile. Programi është i fokusuar në trajnimin e pjesëtarëve të SHKK për menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në

<sup>11</sup> Shih standardet e KPT, paragrafët 50 dhe 51, në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

burgje. Sipas organizatorit, ICITAP planifikon disa projekte të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin dhe rehabilitimin e kësaj kategori të të burgosurve.

36. Nga shërbimi social po ashtu u theksua se u nevojiten trajnime të vazhdueshme profesionale për menaxhim të rasteve specifike, siç janë personat të cilët akuzohen për kryerje të veprave terroriste.

### **Masat disiplinore**

37. Sipas legjislacionit në fuqi dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.<sup>12</sup> Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënime si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, Avokatin e Popullit dhe misionet diplomatike. **MKPT konstatoi se BSL mban regjistër për masat e shqiptuara disiplinore ku shënohen të dhëna lidhur masën e shqiptuar, arsyen, kohën e shqiptimit dhe mbarimit.** Sipas drejtorisë, në shtatë muajt e fundit nuk ka pasur raste të shqiptimit të masës disiplinore të vetmisë dhe raste të vetëlëndimeve.
38. MKPT u njoftua se shërbimi mjekësor nuk jep mendim me shkrim lidhur me aftësinë e të paraburgosurit apo të dënuarit për të përballuar masën disiplinore të vetmisë. MKPT konsideron se pjesëmarrja e mjekut në vendimmarrje, i cili në fakt është mjeku i personit të paraburgosur apo dënuar, do të minonte raportin mjek-pacient, përveç nëse kjo masë ndërmerret për arsye mjekësore.<sup>13</sup>
39. Por, MKPT shpreh shqetësimin për faktin se legjislacioni në fuqi<sup>14</sup> parasheh që para se i burgosuri të vendoset në vetmi drejtori i shërbimit të institucionit korrektues të kërkojë me shkrim mendimin e mjekut i cili dëshmon se i dënuari është në gjendje të mirë shëndetësore fizike dhe psikike. MKPT kërkon nga autoritet relevante që dispozitat në fuqi të këtyre akteve të ndryshohen në pajtim me rekomandimin e KPT në raportin për Kosovën, në pajtim me raportin e përgjithshëm të 21-të të KPT dhe Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec (2006) 2 për Rishikimin e Rregullave Evropiane të Burgjeve, me të cilën u shfuqizua dispozita sipas së cilës kërkohej mendimi me shkrim nga mjeku nëse i burgosuri mund t'i nënshtrohet kësaj mase.

### **Kontakti me botën e jashtme**

40. Legjislacioni në fuqi<sup>15</sup>, në rastin e personave të dënuar përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj e cila zgjatë minimum një orë, si dhe në vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre së paku një herë në 3 muaj me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata.
41. MKPT ka vizituar objektet ku mbahen vizitat familjare dhe vizitat e lira të cilat janë në nivel shumë të kënaqshëm.
42. Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese<sup>16</sup> përcakton se i dënuari ka të drejtë në biseda telefonike me anëtarët e

<sup>12</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>13</sup> Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka kërkuar nga autoritetet relevante që të ndërpritet praktika e kërkesës nga mjeku i vërtetimit se i paraburgosuri apo i dënuari është në gjendje për ta përballuar masën.

<sup>14</sup> Neni 107 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe neni 76 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

<sup>15</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

<sup>16</sup> Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë minuta).

43. Në BSL, të burgosurve në regjimin e avancuar u lejohen 3 telefonata në javë nga 15 minuta, 2 vizita familjare në muaj të cilat zgjasin 1 orë, çdo 2 muaj lejohet vizita e lirë e cila zgjatë 3 orë.
44. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*” bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.
45. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund të vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit.
46. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo zyrën përkatëse të shtetit shtetësinë e të cilit e ka ai.<sup>17</sup> Gjatë vizitës, MKPT i ka intervistuar një shtetas të huaj i cili nuk pati ankesa lidhur me gëzimin e të drejtës për të kontaktuar me konsullatën apo ambasadën e shtetit të tij.
47. I dënuari S.G, shtetas i Republikës së Serbisë, iu ankua MKPT lidhur me çështjen e vizitave familjare, pasi që sipas pohimeve të tij ata jetojnë në Beograd dhe e kanë vështirë ta vizitojnë në BSL. Ankuesi pohoi se kishte mungesë të librave dhe se ato zakonisht silleshin nga Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë.
48. Lidhur me këtë ankesë, MKPT u njoftua nga drejtoria e BSL se zyrtari social kohë pas kohe merr libra në gjuhën serbe nga Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë dhe i sjell në BSL. **Po në të njëjtën ditë zyrtari social kishte sjellë tituj të ri të librave në gjuhën serbe.**
49. **MKPT nuk ka pranuar ankesa lidhur me të drejtën për kontakte me botën e jashtme as nga të dënuarit dhe as nga të paraburgosurit tjerë.**

#### **Procedurat e pranimit**

50. Në BSL, të sapo pranuarve u hapet dosja personale ku futen të dhënat e parapara me ligj dhe të cilat më pastaj futen edhe në bazën e të dhënave të këtij institucioni. Të sapo pranuarit njoftohen me shkrim për të drejtat e tyre. Në secilin krah të pavijoneve gjendet një kopje e rendit shtëpiak.

#### **Çështje të ndërlidhura me sigurinë**

51. Gjatë vizitës MKPT ka vërejtur se edhe më tej i ashtu quajtur *peper spray* është pjesë e pajisjeve standarde tek disa zyrtarë korrektues. **KPT në raportet për vizitat në Kosovë në vitin 2011 dhe 2015 ka kërkuar nga autoritet relevante që të ndërpritet kjo**

---

<sup>17</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, neni 33 paragrafi 1.

praktikë duke pasur parasysh efektet dëmtuese që kanë substancat dhe që kjo pajisje të mos jetë më pjesë e pajisjeve standarde të zyrtarëve korrektues.

52. Në përgjigjen me shkrim të drejtorit lidhur me Peper spray potencohet se *“që nga viti 2010, Peper spray ishte pjesë e pajisjeve standarde të sigurisë personale për stafin korrektues, në BSL tani për tani këtë pajisje e posedojnë vetëm një numër i stafit të cilët janë të trajnuar për intervenime dhe kapje dhe kontroll të trazirave”*.
53. Sipas drejtorisë gjatë këtij vitit në BSL nuk janë regjistruar raste të dhunës ndërmjet të burgosurve.
54. MKPT u njoftua nga drejtorja se 95% e hapësirës së BSL është e mbuluar me kamera të sigurisë. **MKPT rritet rëndësinë e pajisjes me kamera të sigurisë në korridore, pavijone dhe hapësira të jashtme të cilat, në fakt përbëjnë një nga garancitë për mbrojtje nga keqtrajtimi, por edhe garanci për zyrtarët korrektues nga akuzat false për keqtrajtim apo përdorim të tepruar të forcës fizike.**<sup>18</sup> Në raportin për Irlandën në vitin 2010, KPT inkurajon autoritetet relevante të instalojnë sa më shumë kamera të sigurisë në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria.

### **Procedura e parashtrimit të ankesave dhe inspektimit**

55. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.
56. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshinë edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministri i Drejtësisë.<sup>19</sup>
57. MKPT ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në BSL janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e veçanta të vendosura nga personeli mjekësorë të cilat shërbejnë vetëm për ankesa shëndetësore, si dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. **MKPT nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me çështjen e parashtrimit të ankesave apo vonesa për të shqyrtuar ankesat e tyre brenda afatit ligjor.**
58. Në kuptim të procedurave të inspektimit, monitorimi i rregullt i institucioneve të SHKK bëhet nga MKPT e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe disa organizata të shoqërisë civile.

---

<sup>18</sup> KPT, raporti për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18.


<sup>19</sup> Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

**Shërbimit Korrektues të Kosovës:**

- Të ndërmerren hapat e duhur për të sanuar dëmtimin e dyshemeve në stacionarë dhe në pavijonet e BSL ku ato janë dëmtuar;
- Të evitohet mangësia sa i përket ngjyrës së bardhë reflektuese e cila është pengesë për aktivitete jashtë qelive;
- Të burgosurve t'u mundësohet qasja në shtypin ditor;
- Të funksionalizohet punësoria për trajnime profesionale;
- Të shtohen aktivitetet për të paraburgosurit;

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit